

MONITORIMI I  
ZBATIMIT TË SË DREJTËS SË INFORMIMIT  
NË  
SISTEMIN E DREJTËSISË

**Testim praktik i të drejtës së informimit**

# MONITORIMI I

## ZBATIMIT TË SË DREJTËS SË INFORMIMIT

NË

## SISTEMIN E DREJTËSISË

*Ky monitorim është kryer në kuadrin e projektit “Përmirësimi i aksesit në informacion për mediat dhe qytetarët,” të zbatuar me partneritetin e Civil Rights Defenders dhe kontributin financiar të Swedish International Development Cooperation Agency. Pikëpamjet e shprehura në dokument nuk reflektojnë medoemos mendimin e Civil Rights Defenders.*

## *Hyrje*

---

Shqipëria prej 15 vitesh tashmë ka një ligj për të drejtën e informimit. Edhe pse i konsideruar si një ligj relativisht i mirë në adoptimin e tij, në këtë moment diskutohet sërish ndryshimi i tij për një rregullim më të kënaqshëm të së drejtës së qytetarëve për t'u informuar.

Në të njëjtën kohë, si qytetarët, ashtu dhe mediat, kanë pakënaqësi të vazhdueshme në lidhje me transparencën e administratës dhe zbatimit të së drejtës së informimit. A është e justifikuar kjo pakënaqësi? Sa njihet dhe sa përdoret në të vërtetë ky ligj i rëndësishëm? Cilat janë problemet kryesore që ndeshen në këtë aspekt? Monitorimet në praktikë të zbatimit të ligjit janë tejet të pakta dhe të rralla për t'u përgjigjur me saktësi. Megjithatë, fakti që monitorimi i zbatimit në praktikë të kësaj të drejte në kohët e fundit është rritur është një tregues i rëndësisë që po i kushtohet aksesit në informacion nga dita në ditë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të së drejtës së informimit si për shoqërinë, ashtu dhe për median, ky material synon të hedhë më shumë dritë mbi zbatimin e këtij ligji në jetën e përditshme. Më konkretisht ky material përqendrohet në zbardhjen e praktikës së të drejtës së informimit në gjykata dhe sistemin gjyqësor në tërësi. Ky sistem, ndër më të akuzuarit në shoqërinë shqiptare, duhet të jetë edhe shembull i transparencës dhe zbatimit të ligjit për gjithë sistemin tjetër shtetëror. Deri në ç'masë arrihet kjo? Cilat janë problemet kryesore dhe ku çalon i gjithë procesi në dhënien e informimit për gazetarët? Këto pyetje ishin ato që nxitën një monitorim në praktikë të zbatimit të ligjit për informim nga gjykatat dhe institucione të tjera të sistemit gjyqësor në vend.

## *Zbatimi i të drejtës për informim në praktikë*

---

Një nga akuzat më të shpeshta që bëhen ndaj administratës publike lidhen me prirjen për mbyllje ndaj medias dhe publikut dhe mungesën e transparencës. Në këtë aspekt, përdorimi i Ligjit Për Të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare është mjeti kryesor që kanë mediat dhe publiku në përgjithësi për të marrë informacionin që dëshirojnë nga administrata. Megjithë akuzat dhe pakënaqësinë e vazhdueshme në lidhje me këtë aspekt të punës së administratës, ka shumë pak përpjekje për të provuar në praktikë se sa qëndron kjo pakënaqësi ndaj administratës.

Nga ana tjetër, një nga sektorët më problematikë të sistemit shqiptar konsiderohet gjerësisht pushteti gjyqësor dhe sidomos gjykatat. Mediat kanë një funksion kyç në monitorimin dhe nxitjen e vigjilencës ndaj zbatimit të ligjit. Disa nga mjetet kryesore janë nxitja dhe intensifikimi i gazetarisë investigative, një hapje më e madhe e gjykatave, monitorimi i procedurave ligjore dhe administrative. Gjithashtu, aksesit në informacione apo dokumenta zyrtare të sistemit gjyqësor është një e drejtë e gjithë qytetarëve shqiptarë. Është gjithashtu një detyrë e medias të përdorë dhe kërkojë këtë akses për të informuar qytetarët shqiptarë. Duke pasur parasysh të gjitha këto, Instituti Shqiptar i Medias, me ndihmën dhe bashkëpunimin e një grupi prej 10 gazetarësh zhvilloi një monitorim të transparencës së gjykatave dhe sistemit gjyqësor duke testuar zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

### ***Testimi i ligjit për të drejtën e informimit***

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për zbatimin në praktikë të ligjit për të drejtën e informimit u krye një testim për masën dhe mënyrën e zbatimit të ligjit nga pushteti gjyqësor. Natyrisht, qëllimi kryesor ishte të shihej në terren se si veprojnë institucionet e pushtetit gjyqësor kur gjenden përballë kërkesave për informacion dhe jo vetë informacioni në vetvete. Ky ushtrim krijoi mundësinë që të flitej me prova konkrete në aspektin e transparencës së gjykatave ndaj medias, si dhe të identifikoheshin fushat më problematike ku mund të ndërhyhet në të ardhmen.

### ***Metodologjia***

---

Testimi i zbatimit të ligjit nisi me krijimin e një kampioni të institucioneve të cilat do të testoheshin për zbatimin e të drejtës së informimit kundrejt medias. Qëllimi ishte që përzgjedhja e institucioneve të sistemit gjyqësor të ishte me një shtrirje të gjerë dhe të larmishme për sa i përket nivelit, fushës që mbulon, si dhe kompetencave që ka secili institucion. Kjo lloj përzgjedhje synonte të ishte një përfaqësim sa më i arsyeshëm i pushtetit gjyqësor shqiptar. Për arsye të kohës dhe mundësive të kufizuara, ky testim i së drejtës për informim u krye vetëm me administratën në kryeqytet. Përzgjedhja e institucioneve u bë në bashkëpunim me gazetarë që mbulojnë gjykatat dhe çështjet e drejtësisë në vend, për shkak të përvojës së tyre të përditshme në këtë fushë.

Pasi u përcaktua lista e strukturave ku do të kërkohej informacion, u përgatitën 50 kërkesa për informacion. Këto kërkesa ishin relativisht të thjeshta, me qëllim që informacioni i ndërlikuar, i hollësishëm, apo i ndjeshëm të mos bëhej shkas për refuzimin e administratës për të kthyer përgjigje. Megjithatë, disa nga gazetarët patën një qasje tjetër dhe përgatitën pyetje me natyrë më investigative, të lidhura me çështje të ditës, apo të lidhura me betejën politike në vend. Në fakt, këto lloj pyetjesh krijuan mundësinë për të testuar pozicionin dhe praktikën e të njëjtit institucion të gjendur para dy kërkesave të ndryshme: njërin informacion të thjeshtë dhe statistikor dhe tjetrën me sfond të diskutueshëm politik.

Për dërgimin e kërkesave për informacion u krijua një grup me 10 gazetarë. Nga këta, 7 gazetarë mbulojnë çështjet e drejtësisë, ndërsa tre të tjerët mbulojnë politikën dhe kulturën, pra nuk e njohin sistemin gjyqësor dhe nuk kanë burimet e tyre të informacionit në këtë sistem. Arsyeja për këtë ndarje në grup ishte që të vërehej nëse ka ndonjë ndryshim në përgjigjet e administratës së pushtetit gjyqësor në kërkesat që bëjnë gazetarë që njohin sistemin dhe zyrtarët në krahasim me ato që bëjnë gazetarë që nuk e njohin këtë sistem. Për këtë arsye, pasi secili nga aplikantët hartoi 5 kërkesa për informacion për organe të ndryshme të pushtetit gjyqësor. Gazetarëve iu kërkuar që këto kërkesa t'i paraqisnin me letrën me kokë të medias ku punonin, së bashku me vulën përkatëse dhe me firmën e kryeredaktorit, në mënyrë që kërkesa të ishte zyrtare dhe të dukej qartë se vinte nga organe mediatike. Asnjë nga kërkesat nuk jepte ndonjë arsye se përse kërkohej informacioni, gjë që ligji nuk e kërkon.

Kërkesat për informacion u dërguan gjatë muajit shtator dhe tetor, pa ndonjë grafik të caktuar apo të ndarë. Aplikantëve iu kërkuar që të përpiqeshin të merrnin numrat e protokollit për kërkesat që dorëzonin, si dhe të vinin re të gjitha hollësitë në procesin e aplikimit, të tilla si pritja nga administrata, strukturat përgjegjëse, protokollimi, kontakti me drejtorinë përkatëse, marrja e informacionit, reagimi nga administrata, cilësia e përgjigjes së marrë, koha për t'u përgjigjur, etj.


### *Rezultatet kryesore të testimit në praktikë të së drejtës së informimit*

---

I gjithë procesi i aplikimit të kërkesave për informacion u monitorua për të vërejtur se cilat ishin prirjet kryesore të sjelljes së institucioneve të sistemit gjyqësor ndaj kërkesave për informacion. Për këtë qëllim, u bë një analizë si sasiore, ashtu dhe cilësore e hapave të ndryshme të procesit të aplikimit. Kështu, u pa përqindja e kthimit të përgjigjeve, koha për të marrë përgjigje, mënyra e kthimit të përgjigjeve, e kështu me radhë. Gjithashtu, u vërejtën dhe reagimet ndaj kërkesave për informacion, cilësia e informacionit të dhënë, gatishmëria për të dhënë informacion, si dhe aspekte të tjera të veçanta që mund të vëreheshin.

#### ▪ *Marrja e përgjigjeve dhe cilësia e tyre*

Nga 50 kërkesa për informacion të dërguara pranë institucioneve të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe atij gjyqësor në kryeqytet u morën përgjigje në 30 raste, ndërkohë që në 20 raste të tjera nuk pati asnjë lloj përgjigje. Grafiku i mëposhtëm paraqet kthimin e përgjigjeve të marra në përqindje:



*Grafiku nr.1 "Kthimi i përgjigjeve" (N=50)*

Pra, kemi 40% të kërkesave që nuk kanë marrë asnjë lloj përgjigje nga institucione të caktuara të sistemit gjyqësor, një përqindje relativisht e lartë e refuzimit të dhënies së informacionit. Duhet të vërejmë që ky rezultat është pothuajse identik me rezultatin e testimit të të gjithë administratës, të bërë nga Instituti i Medias me gazetarë dhe qytetarë në fund të vitit 2012, ku u morën përgjigje për 61% të kërkesave.

Natyrisht që një element shumë i rëndësishëm dhe domethënës i përgjigjeve të marra është dhe cilësia e informacionit që merret. A është ajo që kërkohet? A është i plotë apo i cunguar? A të orienton gjykata apo institucioni i sistemit të drejtësisë në rastet kur i drejtohesh autoritetit të gabuar për një informacion të caktuar? Të gjitha këto pyetje u morën parasysh gjatë vëzhgimit të aplikimit të kërkesave për informacion.

Për qëllimin e vlerësimit të cilësisë së përgjigjeve të marra, llojet e përgjigjeve u klasifikuan paraprakisht në kategoritë e mëposhtme:

***E plotë*** = informacioni është ai që kërkohet dhe është i plotë.


***E pjesshme*** = informacioni është ai që kërkohet, por jepet i cunguar.

***Negative*** = refuzohet kërkesa ose nuk merret asnjë informacion.

***Referencë*** = jepet përgjigje duke të këshilluar që t'i drejtohesh një ligji, uebsajti, apo një dokumenti të caktuar.

***Transferta*** = përgjigja konsiston në këshillën për t'u drejtuar te një institucion tjetër që është më i përshtatshëm për informacionin e kërkuar.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e përgjigjeve sipas cilësisë së informacionit të marrë.




*Grafiku nr.2 "Lloji i përgjigjes së kthyer" (N=50)*

Si mund të vërehet nga grafiku, 30% e gjithë kërkesave për informacion kanë marrë përgjigje që mund të konsiderohet e plotë, kurse 24% e tyre kanë marrë një përgjigje të pjesshme. Ajo që është vërejtur në përgjigjet e pjesshme ka qenë kryesisht dhënia e një informacioni të përgjithshëm, pa specifikat e kërkuara nga aplikanti. Në disa raste, ndërkohë që gazetarët kanë kërkuar vënien në dispozicion të dokumenteve specifike, sipas të drejtës që jepet në ligj, ato nuk janë dhënë, por është marrë një përmbledhje apo një informacion i përgjithshëm, jo në përputhje me kërkesën.

Në 6% të rasteve është dhënë një lloj transferte ose një zgjidhje e mesme: ndërkohë që gazetarët kanë kërkuar informacion, iu është ofruar një intervistë direkte me një titullar në institucion për të marrë përgjigje për pyetjet e tyre. Ndërkohë, në 40% të rasteve aplikantët nuk kanë marrë asnjë lloj përgjigje. Vetëm në një rast, një nga aplikantët është marrë në telefon pas depozitimit të kërkesës për t'i komunikuar se kërkesa po shqyrtohej. Megjithatë, dy muaj më vonë ajo nuk kishte marrë asnjë përgjigje.

- ***Koha e kthimit të përgjigjes***

Një tjetër element i rëndësishëm i vëzhguar gjatë aplikimit për informacion ishte dhe koha që iu desh institucioneve për të kthyer përgjigje. Duke qenë se në ligj lejohet një kohë relativisht e gjatë për të kthyer përgjigje nga ana e administratës, ishte e rëndësishme të shihej se sa kohë në të vërtetë merrte administrata për të kthyer përgjigje, sidomos në raste të kërkesave pak a shumë të thjeshta, si ishte ky testim.




*Grafiku nr.3 “Kohëzgjatja e përgjigjes” (N=30)*

Duke llogaritur një mesatare të kohës që janë dashur për të gjitha kërkesat, del se janë dashur mesatarisht 10.6 ditë për të marrë përgjigje për një kërkesë të caktuar. Si mund të shihet nga grafiku, gjysma e përgjigjeve janë dhënë në më pak se 5 ditë. Më tej kemi 5 kërkesa që kanë marrë informacion për më pak se 10 ditë. Ky ritëm i kthimit të përgjigjes mund të konsiderohet relativisht i kënaqshëm, edhe pse në rastin e medias koha mund të duket disi e gjatë. Megjithatë, ka edhe 6 kërkesa që u është dashur më shumë se 20 ditë që të marrin përgjigje dhe 1 kërkesë tjetër edhe më shumë se 30 ditë. Pra, ka një prirje që përgjigja kur merret të jetë relativisht e shpejtë, por nuk mund të përgjithësohet në këtë fushë. Ka të ngjarë që ritmi të varet edhe nga informacioni i kërkuar, nga infrastruktura e institucionit dhe ndoshta dhe nga objekti i punës së institucionit.

Krahasuar me monitorimin e një viti më parë, ku u dërguan 250 kërkesa për informacion në të gjitha nivelet e administratës në kryeqytet, koha e marrjes së përgjigjes nga pushteti gjyqësor është rritur: për gjithë administratën në 2012 ka qenë 9 ditë, ndërsa për gjyqësorin 10.6 ditë. Ndërkohë, duhet vërejtur se në testimin e përgjithshëm të administratës kishte dhe raste kur përgjigja është kthyer brenda ditës për aplikantët, ndërkohë që për institucionet e gjyqësorit kjo nuk ka ndodhur.

Natyrisht që shpejtësia në dhënien e informacionit lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e informacionit të kërkuar, volumin, infrastrukturën e institucionit në lidhje me dhënien e informacionit dhe edhe me vetë natyrën e punës së institucionit dhe sa e lejon kjo e fundit të jetë e hapur ndaj publikut. Në këtë kontekst, u pa edhe mesatarja e ditëve që është vonuar përgjigja sipas institucioneve. Si mund të pritët, organet e prokurorisë e kanë vonuar më shumë përgjigjen, për shkak të verifikimit nëse mund të jepet informacioni apo dëmton ndonjë proces hetimor. Grafiku i mëposhtëm e shtjellon me hollësi mesataren e secilit institucion në kthimin e përgjigjes:





Grafiku nr.4 “Kohëzgjatja e përgjigjes sipas institucioneve” (N=30)

Duhet theksuar se në disa raste gazetarët kanë këmbëngulur që të marrin informacion duke vajtur disa herë pranë institucionit, sidomos në rastin e prokurorisë. Edhe pse kanë marrë një ndjesë për vonesën, sërish u desh të paktën një muaj për të marrë përgjigje, edhe pse ato që kërkoheshin ishin thjesht informacione statistikore.


### Modalitetet e aplikimit dhe përgjigjes

Një tjetër aspekt i vëzhguar gjatë procesit të aplikimit ka qenë edhe kushtet për aplikimin, lehtësia apo vështirësia në dërgimin e kërkesës, protokollimi i kërkesës, si dhe kthimi i përgjigjes dhe komunikimi gjatë gjithë kësaj kohe.

#### ➤ *Pranimi i kërkesës*

Sipas testimit të përgjithshëm të kryer në vitin 2012, dërgimi, pranimi dhe protokollimi i kërkesës ka qenë një hallkë relativisht problematike në procesin e aplikimit të kërkesave për informacion. Kjo jo aq për ndonjë tendencë apo pengesë nga ana e administratës, por thjesht për shkak të një mungese të një procedure të unifikuar, të qartë dhe të shpallur për të gjithë në rastin e pranimit të kërkesave për informacion. Gjithashtu, duke qenë se në 2012 testimi ka përfshirë dy grupe, gazetarë dhe qytetarë, përballja e qytetarëve me institucionet në këtë aspekt ka qenë relativisht negative.

Përsa i përket monitorimit të vitit 2013 për sistemin gjyqësor, aspekti i pranimit të kërkesës nuk ka qenë aspak problematik.



*Grafiku nr.5 "Mënyra e dërgimit të kërkesës" (N=50)*

Kështu, të gjithë aplikantët e nisën procesin e dorëzimit të kërkesave pranë zyrave të institucioneve përkatës. Ndërkohë që në vitin 2012, gati 40% e kërkesave nuk janë pranuar dorazi dhe është kërkuar që ato të dërgohen me postë, testimi i vitit 2013 vetëm për institucionet e sistemit të drejtësisë nuk pati asnjë rast të mospranimit apo kthimit të kërkesës. Kështu, tetë nga gazetarët i kanë dorëzuar kërkesat dorazi pranë institucioneve, ndërkohë që dy të tjerë i kanë dërguar kërkesat me postë. Vlen për t'u përmendur që asnjë nga institucionet ku kërkesa është dërguar me postë nuk kanë dërguar përgjigje për aplikantët. Kjo do të thotë që niveli i përgjegjshmërisë së institucioneve mund të jetë më i ulët në rast se nuk ka përballje personale, por nëpërmjet postës. Në fakt, një nga qëllimet e amendamenteve të reja për ligjin për të drejtën e informimit synon pikërisht këtë: zyrtarizimin e kërimit të informacionit me çfarëdolloj mjeti (e-mail, telefon, kërkesë dorazi, kërkesë me postë, etj.) si dhe mundësinë e kthimit të përgjigjes zyrtare me të njëjtat mjete.

#### ➤ *Protokollimi i kërkesës*


Që në fillim të procesit të aplikimit u këmbëngul që aplikantët të merrnin një numër protokoll për kërkesën që dorëzonin, si një mjet për kontrollin e marrjes së përgjigjes nga institucionet dhe për ndjekjen e gjithë procesit me një lehtësi më të madhe. Ndryshe nga viti 2012, kur protokollimi ka rezultuar problematik në një numër të konsiderueshëm rastesh, në këtë rast monitorimi ka qenë një proces relativisht i lehtë.

Në disa nga institucionet i vetmi kufizim ishte që kërkesat për informacion duhej të dorëzoheshin sipas orareve dhe ditëve të caktuara në pritjet me popullin. Kjo procedurë krijon një lloj vonese për gazetarët sidomos, por nga ana tjetër është dhe një siguri se ekziston një strukturë që përgjigjet dhe që merr në dorëzim kërkesat.

Në 2-3 raste punonjësit e administratës që protokollonin kërkesat iu kërkuan gazetarëve elemente shtesë, si firma e kryeredaktorit, vula e redaksisë, apo gjëra të ngjashme. Edhe pse nuk pati probleme pasi gazetarët sqaruan që informacioni nuk kërkohej nga kryeredaktori, por nga gazetari dhe kjo firmë duhet të mjaftojë, sërish këto episode tregojnë që duhet patjetër unifikuar i njëjti standard për kërkesat e informacionit, të pranuar dhe zbatuar nga e gjithë administrata.

### ➤ *Marrja e përgjigjes*

Mënyra e marrjes së përgjigjes, në ato raste kur është kthyer përgjigje, ka qenë në mënyra të ndryshme. Aplikantët kishin lënë si kontakte edhe adresë poste, edhe e-mail, edhe telefon. Në më shumë se gjysmën e rasteve, përgjigjet janë kthyer dorazi, duke u protokolluar sërish në rrugë zyrtare.



Grafiku nr. 6, "Mënyra e kthimit të përgjigjes" (N=30)

Si mund të shihet nga grafiku, mënyra më e zakonshme për të kthyer përgjigje ka qenë dorëzimi në institucion i përgjigjes. Kjo ka ndodhur pasi aplikantët janë marrë në telefon dhe iu është komunikuar se përgjigja është gati.

Në 33% të rasteve përgjigjet janë kthyer me anë të telefonit dhe e-mailit. Në disa raste, administrata ka shprehur gatishmërinë edhe për pritje në zyrë të aplikantëve, me qëllim të sqarimit apo dhënies së informacionit të mëtejshëm. Po kështu, disa nga kërkesat për informacion të gazetarëve u shoqëruan edhe me kërkesa për intervistë, kërkesa që të gjitha u pranuan nga autoritetet. Në krahasim me vitin 2012, kur gati gjysma e përgjigjeve u kthye me postë, këtë vit kjo procedurë nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë ka qenë minimale.

***Citime nga përvoja e aplikantëve në zbatimin e të drejtës për informim***

“Edhe pse ne shpesh përpilojmë një kërkesë me pyetje konkrete rreth informacionit që kërkohet dhe më pas i dërgohet zyrës së shtypit apo sekretarisë, pasi protokollohet kjo shkresë në formë zyrtare nga insitucioni, përgjigja zakonisht kthehet në rrugë verbale dhe jo zyrtare.”

“Në rastet më të shumta zyrat e shtypit dhe zëdhënësit apo këshilltarët për mediat janë ata që luajnë një rol shumë vendimtar në ofrimin e informacionit, qoftë kjo në rrugë zyrtare apo jozyrtare. Ndërkohë që praktika e krijimit të strukturave vetëm për dhënien e informacionit është shumë e dobët.”

“Në raste delikate, kur informacioni që kërkohet nga media është konfidencial, atëherë fjalën e fundit e thotë titullari. Nuk janë të pakta edhe rastet kur media shfrytëzohet nga ana e institucionit. Këtu i referohem atyre rasteve kur policia dhe prokuroria ofron informacion jo të saktë për arrestime apo hetime për çështje të caktuara.”

“Në përgjithësi institucionet e sistemit të drejtësisë përgjigjen të kthejnë një lloj përgjigje kur ia kërkojnë gazetarët. Megjithatë, shumë shpesh është tendenca që përgjigja të devijojë nga pyetja. Ajo që vihet re është që jepet një informacion i përgjithshëm, i thatë, dhe shpesh jashtë kontekstit apo thelbit të pyetjes së bërë.”

“Institucionet kthejnë përgjigje në varësi të temës. Nëse bëhet fjalë për statistika të përgjithshme dhe shifra pa ndonjë zarar, ato i japin. Nëse iu bëhet një pyetje që ka lidhje direkt me punën e institucionit, me mungesën e transparencës, apo me çështje të ndjeshme, ato të japin një informacion të përgjithshëm që nuk të hyn në punë fare ose nuk të kthejnë përgjigje fare.”

“Në disa institucione është e vështirë të hysh për të dorëzuar një kërkesë. Edhe pse unë nuk pata probleme sepse jam gazetarë që mbuloj fushën dhe më njohin në institucion, për gazetarë të tjerë apo për qytetarë është tejet e vështirë kjo gjë.”

“Më kthyen përgjigje të shkurtra dhe aspak specifike, ndërkohë që unë iu kërkova gjëra konkrete.”

“Zakonisht kur kërkojmë statistika institucionet janë të gatshme t'i japin. Kjo sepse është edhe një lloj rasti për të përmirësuar imazhin dhe për të bërë marrëdhënie publike. Po bëjmë ndonjë pyetje të nxehtë vështirë se marrim ndonjë përgjigje. Pra, jepet informacioni që duan ata, jo patjetër informacioni që kërkojmë ne.”

“Unë isha gazetar i ri në atë institucion dhe u desh të shkoja 5-6 herë që të pyesja për kërkesat. Ndërkohë gazetarët që mbulojnë institucionin nuk kishin ndonjë problem.”

## Përfundimet kryesore

Përmirësimi i zbatimit të së drejtës për informim është themelor për një shoqëri më demokratike, më të hapur dhe për një qeverisje më transparente. Megjithë përmirësimin e situatës në disa aspekte të zbatimit të së drejtës për informim, mbetet ende mjaft për të bërë në këtë drejtim. Ndryshimet e duhura janë në tri aspekte kryesore: rregullimi ligjor, praktika administrative dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve.

Përsa i përket rregullimit ligjor, edhe pse ligji nuk mund të konsiderohet problematik në vetvete, aspekte të tij mbeten të diskutueshme. Elemente të tilla si shkurtimi i afatit kohor për të dhënë informacion, përgatitja e një liste shterruese për rastet kur mund të mohohet informacioni, përkufizimi më i qartë i autoritetet publik, duhet të rishikohen me qëllim përmirësimin e ligjit.

Krahasuar me monitorimet e mëparshme të zbatimit të së drejtës për informim, ky monitorim dëshmoi se në krahasim me monitorimin e kryer një vit më parë nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në praktikën e dhënies së informacionit. Gjithashtu, ai konfirmoi se në një numër të konsiderueshëm rastesh mbeten ende probleme të lidhura me praktikën e administratës së sistemit të drejtësisë në dhënien e informacionit. Edhe pse gjykatat dhe institucionet e sistemit të drejtësisë duken më të përgatitura nga ana e infrastrukturës dhe procedurës për të pritur kërkesa për informacion dhe për t'i përmbushur ato, sërish ka probleme të theksuara. Problemet mbeten në cilësinë e dhënies së përgjigjes, në shmangjen e çështjeve të ndjeshme, në favorizimin e gazetarëve që mbulojnë sistemin, si dhe në disa raste në vonesën e dhënies së përgjigjes

### *Aneks 1: Lista e Institucioneve të testuara dhe rezultatet përkatëse*

<b>Nr.</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Nr. i kërkesave</b>	<b>Përgjigje pozitive</b>	<b>Përgjigje negative</b>
1	ALUIZNI	1	0	1
2	Avokatura e Shtetit	2	0	2
3	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	1	1	0
4	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	2	2	0
5	Gjykata e Apelit	5	4	1
6	Gjykata e Lartë	6	6	0
7	Gjykata e Shkallës së Parë	3	3	0
8	Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	1	1	0
9	Gjykata Kushtetuese	4	1	3
10	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	1	0	1
11	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	3	3	0
12	Ministria e Drejtësisë	5	0	5
13	Prokuroria e Përgjithshme	5	3	2
14	Prokuroria e Tiranës	11	6	5
	<b>Gjithsej</b>	<b>50</b>	<b>30</b>	<b>20</b>

## *Aneks 2: Testime të mëparshme për zbatimin në praktikë të së drejtës për informim*

---

Testimi në praktikë i të Drejtës për Informim ka qënë sporadik dhe i rrallë. Ka shumë pak informacion për shkallën e njohjes së këtij ligji dhe të drejte nga qytetarët, për masën e përdorimit të këtij ligji, si dhe për respektimin nga administrata të kësaj të drejte. Ndërkohë që media duket se e njeh më shumë këtë ligj dhe e përdor më shumë për qëllimet e punës së saj, sërish nuk ka dokumentim të rregullt për përgjigjet që merr nga administrata.

Edhe ato pak studime apo testime në praktikë që janë bërë, janë sporadike, me distancë të konsiderueshme kohe nga njëri-tjetri dhe me një metodologji të ndryshme. Të gjithë këta faktorë nuk lejojnë që të kemi një vështrim krahasimor në kohë për zbatimin e ligjit për të drejtën për informim nga administrata. Gjithsesi, duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit dhe sidomos të zbatimit të tij, do të ishte e dobishme që të bëhej një përmbledhje e testeve të mëparshme në këtë fushë, për të pasur një pasqyrë sa më të plotë të gjendjes dhe problemeve që hasen.

### *Rezultate nga testime të mëparshme të së drejtës për informim*

---

- Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve (QZHDI) zhvilloi një proces monitorimi për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit nga administrata publike në vitin 2003. Monitorimi u përqendrua në rrethet Tiranë, Shkodër, Kukës, Vlorë, Lushnjë, Gjirokastër dhe Elbasan. Institucione të ndryshme vendore, qendrore dhe të pavarura u përfshinë në procesin e testimit. Sipas këtij testimi, shumica e institucioneve nuk kishin zyrë informacioni për qytetarët. Për më tepër, nuk kishte informacion për mënyrën si duheshin trajtuar kërkesat për informacion. Gjithashtu, u vërejt se më shumë se 87% e administratës nuk e dinte që në Shqipëri ekziston ligji për të drejtën e informimit. Po kështu, pati institucione që refuzuan t'i pranonin kërkesat për informacion.

- Një vit më vonë, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve zhvilloi një tjetër anketim dhe monitorim në lidhje me zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Sipas këtij sondazhi, vetëm 23 % e qytetarëve thanë se ishin në dijeni për të drejtën e informimit dhe si mund të përdoret ajo për të marrë informacion pranë administratës. Ndërkohë, në po të njëjtin monitorim, 69% e punonjësve të administratës gabuan përgjigjen për afatin për të dhënë informacion dhe 15 % thanë se nuk pranonin të jepnin informacion nëse kërkesa nuk ishte e motivuar, pra në kundërshtim të plotë me ligjin.

- Avokati i Popullit, sipas ligjit, ka një rol të veçantë në mbikqyrjen e zbatimit të së drejtës për informim. Edhe pse veprimtaria e Avokatit të Popullit nuk ka rezultuar në monitorime aktive të llojit empirik mbi zbatimin e ligjit, raportet vjetore dhe udhëzimet e Avokatit të Popullit në lidhje me rastet e ankimuarra për të drejtën e informimit janë një dritare tjetër mbi trajtimin e kësaj të drejte nga qytetarët dhe administrata. Duke qenë se rastet e ankimit të paraqitura në raportet vjetore të këtij institucioni ndër vite nuk janë të shumta, mund të arrihet në përfundimin se nuk ka një njohje dhe përdorim të gjerë të ligjit nga qytetarët.

- Një burim tjetër i zbatimit në praktikë të së drejtës për informim vjen nga Transparency International Albania. Në përpjekjen e saj për t'u dhënë qytetarëve asistencë ligjore dhe ndihmë në mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zgjidhjen e konflikteve administrative, kjo organizatë ka bërë një vëzhgim edhe në lidhje me përqindjen e përgjigjeve të marra nga administrata në këtë proces. Sipas vëzhgimit të bërë në vitin 2011, 58% e kërkesave të dërguara për informacion kishin mbetur pa përgjigje. Në disa raste, edhe pas dërgimit të kërkesës disa herë rresht, nuk është marrë asnjë lloj përgjigje.

- Po në vitin 2011, disa organizata ndërkombëtare si Access Info Europe, Centre for Laë and Democracy dhe International Budget Partnership kryen një testim të zbatimit të së drejtës për informim të quajtur "Ask Your government!6 Question Campaign." Në këtë testim u përfshinë 80 vende dhe u testuan institucionet përkatëse në çdo vend në lidhje me 6 pyetje nga fusha të ndryshme. Në renditjen e të gjitha vendeve Shqipëria doli në vend të 25.

- Të njëjtat organizata në 2011 kryen një vlerësim të ligjeve për të drejtën e informimit në 89 vende të botës, nisur nga 61 indikatorë të ndryshëm. Në këtë vlerësim, ligji shqiptar u rendit në zonën me vlerësim të dobët, e pasuar vetëm nga 6 vende të tjera. Kjo tregon që ligji shqiptar për të drejtën e informimit ka nevojë për një përmirësim, sidomos krahasuar me pozicionimin shumë të mirë të vendeve fqinje në këtë vlerësim për standardet ligjore të të drejtës së informimit.

- Në vitin 2012 Instituti Shqiptar i Medias kreu një testim të zbatimit të ligjit nga administrata në praktikë me anë të një grupi gazetarësh dhe një grupi qytetarësh. Nga 250 kërkesa për informacion të dërguara pranë niveleve të ndryshme të institucioneve në kryeqytet u morën përgjigje në 152 raste, ndërkohë që në 98 raste të tjera ose u refuzua përgjigja, ose nuk pati asnjë lloj reagimi nga administrata. Për grupin e gazetarëve pati një përqindje suksesi më të lartë në marrjen e përgjigjes në krahasim me grupin e qytetarëve të thjeshtë. Duke llogaritur një mesatare të kohës për të marrë përgjigje për të gjitha kërkesat, janë dashur mesatarisht 9 ditë për të marrë përgjigje. Përsa i përket lehtësisë në pranim të kërkesave për informim, gati 40% e kërkesave nuk janë pranuar dorazi dhe është kërkuar që



ato të dërgohen me postë, pasi vetëm kështu do të quhej procedura e rregullt. Ndërkohë që edhe gazetarët kanë hasur me raste pengesa logjistike në protokollimin e kërkesave, për qytetarët ka qenë akoma më e madhe vështirësia.

- Në vitin 2012-2013 Qendra Respublica gjithashtu ka kryer një testim të së drejtës për informim nga administrata në nivele të ndryshme hierarkie dhe në zona të ndryshme të Shqipërisë. Aplikimet janë bërë në emër të organizatave të shoqërisë civile, avokatëve, gazetarëve, apo individëve. Nga 202 kërkesa të bëra, autoritetet janë përgjigjur në 59 raste, ndërkohë që në 143 raste nuk ka pasur përgjigje. Nga përgjigjet e dhëna 52 janë konsideruar të plota dhe 7 të paplota. Nga 143 rastet e refuzimit të përgjigjes janë paraqitur 142 ankime administrative, ku autoritetet janë përgjigjur pozitivisht në 53 raste dhe negativisht në 89 raste. Përsa i përket shpejtësisë së kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare, koha mesatare e përgjigjes ka qenë 24 ditëm ndërkohë që përgjigja më e shpejtë ka qenë 4 ditë, ndërkohë që më e vonuara ka qenë 61 ditë.